

TOSK ENERGJI SHA

dhe

CFD Conseils SARL

dhe

SkySea B.V.



MARRËVESHJE PENGU

MBI AKSIONET

[Handwritten signature]

[Handwritten signature]

[Handwritten signature]

MARRËVESHJE PENGU MBI AKSIONET


Sot, në 30 shtator, 2016, palët e mëposhtme kanë lidhur marrëveshjen e mëposhtme të pengut mbi aksionet:

- (1) **TOSK ENERGJI SHA**, një shoqëri aksionare e organizuar dhe që funksionon sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, me seli të regjistruar në Rr. Ibrahim Rugova, Nr. 5, Sky Tower, 13/4, Tiranë, Albania, përfaqësuar nga Blerim Hoxha, shtetas Kosovar, i lindur në Suharekë, më 12.04.1983, me pasaportë me nr. P00682170 në cilësinë e përfaqësuesit ligjor (këtu e më poshtë "**Shoqëria**"); dhe
- (2) **CFD Conseils SARL**, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e organizuar dhe që funksionon sipas ligjeve të Zvicrës, me seli të regjistruar në Passage des Lions 6, CH-1204 Geneva, përfaqësuar nga Blerim Hoxha, shtetas Kosovar, i lindur në Suharekë, më 12.04.1983, me pasaportë me nr. P00682170 i autorizuar për qëllim e këtij transaksioni sipas Prokurës datë 29 shtator 2016; (këtu e më poshtë "**CFD**" ose "**Pengdhënësi**"); and
- (3) **SkySea B.V.**, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e organizuar dhe që funksionon sipas ligjeve të Hollandës, me seli të regjistruar në Barbara Strozilaan 201, 1083HN Amsterdam, the Netherlands, përfaqësuar nga Z. Adi Brovina, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë, më 01.5.1984, me letërnjoftim me nr. 027201682 i autorizuar për qëllim e këtij transaksioni mbi bazën e Vendimeve me Shkrim të Bordit të Administrimit dhe Prokurën datë 27 shtator 2016; (këtu e më poshtë "**GUNVOR**" or "**Pengmarrësi**").

Kushtet paraprake:

- (A) Sipas dispozitave të Marrëveshjes së Huasë (siç përcaktohet më poshtë) GUNVOR ka rënë dakord të vejë në dispozicion të Shoqërisë, shumat e huasë të cilat nuk tejkalojnë një total prej EUR 13,000,000 (trembëdhjetë million Euro), për qëllim të blerjes së Terminalit (siç përcaktohet në Loan Agreement) nga Genklaudis SHA.
- (B) CFD Conseils SARL është pronari i regjistruar i 100% (njëqind për qind) të kapitalit aksionar të Shoqërisë, që përfaqëson 3.500.000 Lekë (tre milion e pesëqind mijë Lekë Shqiptarë).
- (C) Si kusht paraprak i detyrimit të GUNVOR për të kryer disbursimet për Shoqërinë mbi bazën e Marrëveshjes së Huasë, Pengdhënësi bie dakord, ndër të tjera, të lëshojë në favor të GUNVOR një Peng të radhës së parë mbi të gjithë aksionet e nënshkruara dhe ekzistuese të Shoqërisë të zotëruara nga Pengdhënësi, në mënyrë që të sigurojë përmbushjen e detyrimeve të Shoqërisë sipas Marrëveshjes së Huasë.
- (D) Palët (siç janë përcaktuar më poshtë) bien dakord që qëllimi i kësaj Marrëveshjeje duhet të jetë t'i mundësojë GUNVOR të fitojë pronësinë e Aksioneve në rast të mospërmbushjes së Shoqërisë në mënyrën më thjeshtë e të shpejtë të mundshme dhe në përputhje me të gjitha ligjet e zbatueshme.

BIEN DAKORD si vijon:



1. PËRKUFIZIMET DHE INTERPRETIMI

1.1 Kushtet paraprake dhe shtojcat

Kushtet paraprake dhe shtojcat e kësaj Marrëveshjeje janë një pjesë thelbësore e saj, detyruese për Palët dhe trashëgimtarët e tyre dhe për të tretët të cilëve do t'u kalojnë të drejtat dhe përfituesit.

1.2 Përkufizimet

Përveç nëse është përcaktuar ndryshe në këtë Marrëveshje, ose konteksti e kërkon ndryshe, termat e përcaktuara, interpretuara ose të vendosur si referencë në Marrëveshjen e Huasë, do të kenë të njëjtin kuptim në këtë Marrëveshje. Në rast konflikti, përkufizimet në Marrëveshjen e Huasë do të mbizotërojnë. Me tej, termat e mëposhtëm do të kenë kuptime:

"Marrëveshje" nënkupton këtë Marrëveshje Pengu mbi Aksionet, së bashku me Shtojcën/at, e ndryshuar dhe/ose e përditësuar herë pas here.

"Ligji shqiptar" nënkupton Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe çdo akt normativ i zbatueshëm ose vendor, urdhër, dekret ose ligj apo rregullore tjetër e Republikës së Shqipërisë në fuqi dhe i zbatueshëm në çdo kohë dhe kohë pas kohe gjatë kohës që do të zbatohet kjo Marrëveshje.

"Ditë pune" nënkupton çdo ditë (përveç të shtunës ose të dielës), kur bankat në Tiranë (Shqipëri), Gjenevë (Zvicër), Nikosia (Qipro), Amsterdam (Holandë) dhe New York (Shtetet e Bashkuara) janë të hapura për veprime të aktivitetit të zakonshëm.

"Kodi Civil" do të thotë Ligji shqiptar nr. 7850, datë 29 korrik 1994, me ndryshimet kohë pas kohe.

"Kodi i Procedurës Civile" do të thotë Ligji shqiptar nr. 8116, të datës 29 mars, 1996, me ndryshimet kohë pas kohe.

"Kolateral" do të thotë Aksionet dhe të Drejtat që lidhen me to.


"Mospërbushje" " është çdo Rast Mospërbushje, ose çdo mospërbushje, shkelje, dështim, ngjarje, gjendje ose kusht i cili, përveçse kur jepet shpërblehet ose hiqet dorë, me njoftimin ose kalimin e afatit të pezullimit do të përbënte ose rezultonte në shkaktimin e një Rasti Mospërbushje.

"Rast Mospërbushjeje" nënkupton çdo mospërbushje, shkelje, dështim, ngjarje, kusht apo gjendje, siç është përshkruar në pikën 11.1 të Marrëveshjes së Huasë, e cila është e vazhdueshme;

"Pengu i Huasë" nënkupton peng i radhës së parë mbi aksionet, e krijuar në favor të Gunvor në bazë të Nenit 2.1 (i) të kësaj Marrëveshjeje dhe sipas ose në përputhje me dispozitat e Marrëveshjes së Huasë.

"Marrëveshja e Huasë" do të thotë marrëveshja e lidhur ndërmjet Gunvor dhe Shoqërisë, në këtë datë, me të cilin Gunvor ka rënë dakord për të vënë në dispozicion të Shoqërisë, kredinë që nuk kalon një total prej 13.000.000 EUR (trembëdhjetë milion Euro), për qëllime të blerjes së Terminalit (siç përcaktohet në Marrëveshjen e Huasë) nga Genklaudis SHA.

"Kërkesat e Njoftimit" nënkupton kërkesat e njoftimeve të përcaktuara në nenet 6.3 dhe 7.2.a) të kësaj Marrëveshjeje që të përfshijnë, por mos të kufizohen në, një përshkrim të shkurtër të Rastit të Mospërbushjes, shumat e papaguara, si dhe referenca të dispozitave specifike të marrëveshjes



sipas të cilës njoftimi është dërguar, duke përfshirë edhe veprimet që Pengmarrësi ka vendosur të marrë;

"Të Drejtat e Lidhura" do të thotë:

- (I) çdo dividend, interes dhe të ardhurat e tjera të paguara ose të pagueshme në lidhje me çdo Aksion;
- (II) çdo Aksion, letrat me vlerë, të drejta, të holla ose pasuri që maturohen apo ofrohen në çdo kohë (qoftë me anë të riblerjes, bonus, preferimit, të drejtat e opsionit, zëvendësimit, këmbimit ose ndryshe) në lidhje me ose në lidhje me ndonjë nga Aksionet (duke përfshirë por pa u kufizuar në të ardhurat e shitjes);
- (III) të gjithë dividendët, interesat ose të ardhura të tjera në lidhje me çdo aset që është përmendur në nënparagrafin (ii) më sipër; dhe
- (IV) të gjitha të drejtat, përfitimet dhe avantazhet aktuale, ose në çdo kohë në të ardhmen që rrjedhin nga apo lidhen me secilin nga Aksionet duke përfshirë të gjitha të drejtat e votës në lidhje me aksionet, të cilat mund të përdoren si në asamblenë e zakonshme edhe në asamblenë e jashtëzakonshme të shoqërisë, të drejta të votimit të cilat bazohen në Nenin 6 të kësaj Marrëveshjeje.

"Detyrimet e Siguruara" janë të gjitha detyrimet dhe përgjegjësitë të tashme apo të ardhshme (qoftë aktuale apo të mundshme, dhe qofshin të detyruara solidarisht apo veç e veç ose në çdo lloj cilësie tjetër dhe qofshin të shkaktuara fillimisht nga Huamarrësi ose çdo person tjetër) të Huamarrësit ndaj Huadhënësit sipas dhe në lidhje me Dokumentet e Financimit siç përcaktohet në Marrëveshjen e Huasë.

"Periudha e Garancisë" është periudha që fillon në datën e nënshkrimit të kësaj Kontrate dhe përfundon në datën që të gjitha Detyrimet e Siguruara janë paguar në mënyrë të pakushtëzuar dhe të pakthyeshme dhe janë shlyer plotësisht.

"Shitës" do të thotë institucioni i kreditimit ose ndërmjetës financiar që do të zgjidhet në bazë të nenit 7.2.

"Aksione" do të thotë i gjithë kapitali aksionar ekzistues dhe i nënshkruar i Shoqërisë, që aktualisht dhe në çdo kohë në të ardhmen nga Pengdhënësi ose mbi të cilin Pengdhënësi ka të drejta.

1.3 Interpretimi

1.3.1 Përveç rastiit kur konteksti përcakton ndryshe, në këtë Marrëveshje një referencë për:

(i) një **"Palë"** i referohet Shoqërisë, ose GUNVOR ose Pengdhënësit, sipas rastiit;

(ii) një **"person"** përfshin çdo person fizik ose juridik shqiptar ose të huaj, shoqëri, ortakëri, entitetor apo joint-veture, çdo njësi vendore të Republikës së Shqipërisë si dhe përfshin trashëgimtarët dhe personat të cilëve u është lejuar kalimi i të drejtave dhe detyrimeve të çdo subjekti sa më sipër;

(iii) një **"rregullore"** përfshin çdo rregullore, vendim, urdhër zyrtar, kërkesë apo direktivë (që mund të ketë ose jo fuqinë e ligjit) të çdo autoriteti qeveritar, agjencie, departamenti apo institucione rregullator, vetë rregullues apo çdo lloj organizate apo autoriteti shqiptar;



(iv) çdo Nen, paragraf apo Shtojcë përben një referencë për këtë Nen, paragraf apo Shtojcë të kësaj Marrëveshjeje, përveçse kur është përcaktuar shprehimisht ndryshe;

(v) çdo ligj i Republikës së Shqipërisë, vendim, dekret apo akt normativ përshin çdo ligj, vendim, dekret apo akt normativ i cili ndryshon apo zëvendëson apo e ka ndryshuar apo zëvendësuar atë tashme dhe përshin çdo akt nënligjor (duke përfshirë, por pa u kufizuar në, çdo lloj udhëzimi apo vendimi të një ministrie apo autoriteti tjetër kompetent) të lëshuar në përputhje me çfarëdo ligji, vendimi, dekreti apo akti normativ;

(vi) "Palët" do të thotë së bashku Shoqëria, Pengdhënësi dhe GUNVOR.

1.3.2 Referimet në ligj ose në dispozitë ligjore, apo dispozita ligjore ose legjislative, apo një udhëzim do të interpretohen, në çdo kohë të caktuar, se përfshijnë çdo referim në ndonjë ndryshim, zgjatje afati ose rivendosje në afat në çdo kohë kur është ne fuqi dhe të gjitha instrumentet, urdhrat dhe ligjet në fuqi dhe të bëra në çdo kohë apo të vlefshme në bazë të dispozitës ligjore apo udhëzimit përkatës;

1.3.3 Referimet në numrin njëjës përfshijnë dhe numrin shumës dhe anasjelltas si dhe fjalët që shprehin personat fizikë do të përfshijë çdo person tjetër.

1.3.3 Titujt në këtë Marrëveshje nuk do të përdoren në interpretimin e përmbajtjes së kësaj Marrëveshjeje;

1.3.4 Referencat në një marrëveshje, akt, instrument, licencë apo dokument tjetër (përfshirë edhe këtë Marrëveshje), apo në ndonjë dispozitë të këtyre akteve do të interpretohet në çdo kohë të caktuar si referim i këtyre akteve duke përfshirë amendamentet, ndryshimet, shtesat, modifikimet, pezullimet apo rinovimet e tyre.

2. OBJEKTI I MARRËVESHJES

2.1 Krijimi i Pengut të Huasë

Pengdhënësi për të garantuar shlyerjen e plotë dhe të pakushtëzuar të Detyrimeve të Siguruara, në mënyrë të parevokueshme vë peng, si një peng të radhës se pare në favor të Gunvor, i cili pranon një peng të tillë, Aksionet dhe të Drejtat që lidhen me to, në lidhje me të drejtat e votës dhe të drejtën për të marrë dividendë, sipas Nenit 6 të kësaj Marrëveshjeje si Peng i Huasë.

2.2 Aksionet e Ardhshme dhe të Drejtat e Lidhura

Pengu i Huasë do të shtrihet automatikisht mbi të gjitha Aksionet e Ardhshme dhe të Drejtat e Lidhura që Pengdhënësi mund të zotërojë herë pas here duke përfshirë, pa kufizim, të gjitha dhe secilën prej Aksioneve të nënshkruara nga Pengdhënësi si rrjedhojë e çfarëdo lloji rritje kapitali. Në lidhje me këtë, Pengdhënësi duhet të nënshkruajë menjëherë një marrëveshje pengu kryesisht sipas formës së kësaj Marrëveshjeje si dhe çdo dokument tjetër, dhe të ndërmarrë çdo veprim tjetër, që mund të jetë i nevojshëm ose i këshillueshëm në mënyrë që secili dhe të gjitha Aksionet dhe të Drejtat e Lidhura të zotëruar nga Pengdhënësi të vendosen peng në favor të Gunvor.

2.3 CFD dhe Shoqëria, pas çdo ndryshimi të ardhshëm të ligjit të Republikës së Shqipërisë nr. 8537, datë 18 tetor 1999 "Për Barrët Siguruese" që lejon krijimin e barrëve siguruese mbi

aksionet e shoqërisë aksionare, në mënyrë të parevokueshme të bien dakord të japin, të krijojnë dhe të kompletojnë, për shlyerjen e plotë dhe të pakushtëzuar të Detyrimeve të Siguruara, një barrë siguroese të radhës së parë mbi Aksionet dhe të Drejtat e Lidhura në favor të Gunvor, i cili pranon një barrë të tillë siguroese, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga njoftimi me shkrim i dërguar nga Gunvor për këtë qëllim palëve të tjera. Palët në mënyrë të parevokueshme bien dakord për të nënshkruar menjëherë këtë marrëveshje ose çdo dokument tjetër dhe t'i dërgojnë Gunvor të gjitha njoftimet dhe çdo dokument tjetër të cilat mund të jenë të nevojshme ose të këshillueshme për dhënien, krijimin ose kompletimin e barrës siguroese të radhës së parë apo për mbrojtjen e vlefshmërisë, efektivitetin dhe zbatueshmërinë e asaj marrëveshjeje apo e të drejtave të Gunvor.


3. DETYRIMET E SIGURUARA

Pengu i Huasë ofrohet si garanci e radhës së parë deri në përmbushjen e plotë dhe të pakushtëzuar të Detyrimeve të Siguruara. Pengu i Huasë nuk do të zbritet në asnjë mënyrë për arsye të pagesës së pjesshme të Detyrimeve të Siguruara dhe do të ketë fuqi të plotë ligjore pavarësisht nga dispozitat e çdo garancie tjetër që është dhënë ose mund të jepet në çfarëdo mënyrë ose nga cilido person përkundrejt GUNVOR.

4. KOMPLETIMI I PENGJEVE

- (a) Brenda kohës më të shkurtër, por sidoqoftë brenda (3) Ditë Pune duke filluar nga data e nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje, Pengu i Huasë do të regjistrohet në regjistrin e aksionarëve të Shoqërisë, sipas Nenit 547 të Kodit Civil, dhe një kopje e noterizuar e kësaj faqe të regjistrimit të aksionarëve të Shoqërisë që provon regjistrimin e Pengut të Huasë do t'i dërgohet menjëherë GUNVOR.
- (b) Përpara nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje, Shoqëria duhet të pajisë GUNVOR me vendimin e mbledhjes së aksionarëve që autorizon krijimin e Pengut të Huasë. Ky vendim do të depozitohet, pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje, në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) dhe një ekstrakt zyrtar nga regjistri tregtar i Shoqërisë që mbahet pranë QKB dhe provon regjistrimin e Pengut të Huasë do t'i dërgohet GUNVOR brenda 10 (dhjetë) Ditëve Pune nga nënshkrimi i kësaj Marrëveshjeje.
- (c) Pengdhënësi dhe Shoqëria me anë të kësaj Marrëveshjeje angazhohen në mënyrë të pakthyeshme që të nënshkruajnë, dorëzojnë, regjistrojnë dhe depozitojnë çdo dokument që GUNVOR e quan të nevojshëm ose të përshtatshëm. Pengdhënësi dhe Shoqëria do të nënshkruajnë, dorëzojnë, regjistrojnë dhe depozitojnë ato dokumente dhe do të kryejnë të gjitha ato veprime siç GUNVOR mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme, për përmbushjen e objektit të kësaj Marrëveshjeje dhe të kompletojnë dhe të sigurojnë vazhdimësinë e Pengut të Huasë, të mbrojnë dhe të ruajnë Kolateralin si dhe të ekzekutojnë të drejtat e GUNVOR që rrjedhin nga kjo Marrëveshjeje.

5. FORMA E REGJISTRIMIT TË PENGJUT NË REGJISTRIN E AKSIONEVE



Forma e regjistrimit, në regjistrin e aksioneve të Shoqërisë në lidhje me Pengun e Huasë, përcaktohet në Shtojcën 1 të këtij dokumenti.

Pengdhënësi dhe/ose Shoqëria, sipas rastit, autorizon Pengmarrësin për të nënshkruar, dërguar, regjistruar dhe të dorëzojë çdo dokument të mëtejshëm që Pengmarrësi konsideron të nevojshëm ose të përshtatshëm, duke përfshirë, për shmangien e çdo dyshimi, dokumentet që Pengmarrësi konsideron të nevojshme ose të përshtatshme për qëllimin e regjistrimit të Pengut në Regjistrin e Aksioneve dhe në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe të ndërmarrë të gjitha hapat e mëtejshëm që mund të jenë të nevojshme për përsosjen e sigurisë që kjo Marrëveshje përpiqet të krijojë (me shpenzimet e Pengdhënësit).

6. TË DREJTAT E VOTËS DHE DIVIDENTËT

6.1 Të drejtat e votës

Deri në vërtetimin e një Mospërbushjeje, të drejtat e votës të lidhura me Aksionet, si në asamblenë e zakonshme ashtu edhe në asamblenë e jashtëzakonshme të aksionarëve të Shoqërisë, do të ushtrohen nga Pengdhënësi, *me kusht që këto të drejta nuk do të ushtrohen në asnjë rast nga Pengdhënësi në atë mënyrë që do të mund të cenonte negativisht vlerën e Aksioneve ose vlefshmërinë ose zbatueshmërinë e kësaj Marrëveshjeje, apo e cila nuk është në përputhje e dispozitat e Marrëveshjeve së Huasë apo çdo marrëveshje tjetër të lidhur me të.*

6.2 Dividendët

Deri në vërtetimin e një Mospërbushjeje, Pengdhënësi ka të drejtë të përfitojë të gjithë dividendët që lidhen me Aksionet.

6.3 Vërtetimi i një Mospërbushjeje

Me vërtetimin e një Mospërbushjeje, GUNVOR do t'i dërgojë një njoftim (në përputhje me Kërkesat e Njoftimit) Pengdhënësit dhe Shoqërisë duke i informuar ata se ka ndodhur një Mospërbushje dhe, gjatë kohëzgjatjes së Mospërbushjes dhe derisa GUNVOR të informojë Pengdhënësin dhe Shoqërinë me shkrim se Mospërbushja ka pushuar së ekzistuari, GUNVOR ka të drejtë, por nuk është e detyruar që:

- (i) Të ushtrojë të drejtat e votës që lidhen me Aksionet, në asamblenë e zakonshme dhe në asamblenë e jashtëzakonshme të Shoqërisë; dhe
- (ii) Të përfitojë të gjithë dividendët që lidhen me Aksionet. Dividendët e përfituar në këtë mënyrë nga GUNVOR do të përdoren për shlyerjen e Detyrimeve të Siguruara. GUNVOR do të ketë të drejtën e ekzekutimit të veçantë për të mbledhur në mënyrë të drejtpërdrejtë nga Shoqëria të gjithë dividendët ose pagesa të tjera, në përputhje me Nenin 550 të Kodit Civil.

7. EKZEKUTIMI I PENGUT

7.1 Ekzekutimi nëpërmjet Shitjes ose Kalimit

- (a) Me vërtetimin e një Mospërbushjeje dhe në çdo kohë pas kësaj, GUNVOR, pa cënuar të drejtat e tij të tjera dhe mjetet ligjore për rivendosjen e tyre sipas kësaj Marrëveshjeje ose

në bazë të ligjit të zbatueshëm, ka të drejtë të deklarojë menjëherë si të kërkueshëm dhe të pagueshëm të gjithë detyrimin e garantuar nga kjo Marrëveshje, dhe të mbledhë shumën e plotë të detyrimit me shpenzime të arsyeshme përfshirë shpenzimet gjyqësore, tarifat e avokatëve dhe të gjithë shpenzimet e tjera ligjore, duke përfshirë të drejtën për të shkaktuar shitjen e Aksioneve dhe të drejtën e pagesës të çdo dëmi ose humbje që GUNVOR mund të pësojë.

- (b) Për heqjen e çdo dyshimi, Palët pranojnë dhe bien dakord se, me vërtetimin e një Mospërmbyshjeje, GUNVOR mund që, sipas zgjedhjes e në diskrecionin e plotë të tij të ushtrojë të drejtat e tij dhe mjetet ligjore për rivendosjen e tyre siç parashikohet nga Kodi Civil në përputhje me Nenin 7.2.

7.2 Ekzekutimi sipas Kodit Civil

- (a) Palët bien dakord se, me vërtetimin e një Mospërmbyshjeje, GUNVOR do t'i dërgojë Pengdhënësit njoftimin në përputhje me nenin 556, paragrafi 1 i Kodit Civil (i cili duhet të përputhet me Kërkesat e Njoftimit). Nëse Pengdhënësi nuk ngre ndonjë kundërshtim sipas Nenit 556, paragrafi 2 i Kodit Civil, GUNVOR do të ketë të drejtë të shkatojë shitjen e Aksioneve, nëpërmjet Shitësit, në përputhje me paragrafët në vijim. Palët bien dakord gjithashtu se, në këtë rast, GUNVOR do të kenë të drejtën të përcaktojnë nëse Aksionet duhet të shiten tërësisht apo pjesërisht, në një ose shumë keste, me ose pa ankand.
- (b) Shitësi zgjidhet nga GUNVOR nëpërmjet njoftimit me shkrim që i dërgohet nga GUNVOR Shoqërisë, Pengdhënësit dhe vetë Shitësit. Palët bien dakord se Shitësi do të kryejë procedurën e shitjes në përputhje me afatet dhe kushtet e përcaktuara nga GUNVOR sipas paragrafit (a) me sipër, dhe do të përcaktojë çmimin e Aksioneve brenda 30 (tridhjetë) ditëve duke filluar nga data në të cilën Shitësi merr njoftimin me shkrim nga GUNVOR. Në përcaktimin e çmimit të Aksioneve, Shitësi mund të marrë parasysh pjesën që Aksionet zënë në kapitalin e Shoqërisë, gjendjen financiare të shoqërisë, fitimet e Shoqërisë dhe vlerën e aseteve të saj, pozitën e Shoqërisë në treg dhe çfarëdo kushti dhe/ose rrethane tjetër të rëndësishme, me kusht që, sidoqoftë, çmimi i përcaktuar nga Shitësi do të jetë në çdo rast i arsyeshëm dhe i pranueshëm në aspektin tregtar nga Gunvor.
- (c) Shitësi do të kryejë procedurën e shitjes së Aksioneve duke identifikuar dhe ftuar blerësit potencialë të dorëzojnë një oferte për blerjen e Aksioneve. Shitësi do të ftojë jo më pak se 5 (pese) blerës potencialë, përfshirë GUNVOR. Ftesa e Shitësit duhet të përmbajë përshkrimin e Aksioneve, çmimin e përcaktuar në përputhje me pikën (b) më sipër dhe afatin përfundimtar brenda të cilit duhen dorëzuar ofertat i cili nuk mund të jetë më i gjatë se 30 (tridhjetë) ditë duke filluar nga data e marrjes së ftesës.
- (d) Shitësi do të vlerësojë ofertat në përputhje me kriteret e çmimit më të lartë, dhe nuk do të marrë në konsideratë ofertat ku çmimi i ofertuar është më i ulët se ai i përcaktuar në përputhje me pikën (b). Shitësi duhet të përfundojë vlerësimin e ofertave brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve duke filluar nga afati përfundimtar për dorëzimin e tyre. Marrëveshja për shitjen e Aksioneve duhet të lidhet brenda 3 (tre) muajve duke filluar nga data e afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave.

- (e) Palët nëpërmjet kësaj Marrëveshje bien dakord në mënyrë të përvokueshme se do të bazohen në vendimet e Shitësit, të cilat janë përfundimtare dhe të detyrueshme për to, me përjashtim të rastit kur një ose më shumë prej tyre mendon me mirëbesim se vendimet e Shitësit janë të pasakta ose qartësisht të padrejta ose kanë ardhur si pasojë e një sjellje të gabuar të Shitësit. Në këtë rast, konfliktet apo mosmarrëveshjet do të zgjidhen sipas nenit 15.2 të kësaj Marrëveshjeje.
- (f) Në rast se asnjë nga ofertat nuk mund të konsiderohet sipas pikës (d), ose nëse Shitësi nuk merr asnjë ofertë, ose marrëveshja për shitjen e Aksioneve nuk lidhet brenda afateve kohore të parashikuara në paragrafin (d), Aksionet do të shiten me ankand publik, në përputhje me Nenin 556 paragrafi 2 i Kodit Civil.
- (g) Për të hequr çdo dyshim, Gunvor mund të ketë të drejtë për të zëvendësuar Shitësin gjatë procedurave të ekzekutimit sipas këtij Neni 7.2 (Zbatimi sipas Kodit Civil) në çdo kohë, nëse kjo është e nevojshme sipas mendimit të arsyeshëm të Gunvor. Një shkëmbim i tillë nuk do të zhvlerësojë ose të dëmtojë ndonjë procedurat e zbatimit të kryera tashmë nga Shitësi precedentit në pajtim me këtë klauzolë 7.2 (Zbatimi sipas Kodit Civil), nëse nuk shprehet në mënyrë eksplicite ndryshe nga Shitësi re ose Gunvor.

8. ZEVENDESIMI DHE NENRENDITJA

8.1 Heqja dore nga e drejta e zëvendësimit nga ana e Pengdhënësit

Pengdhënësi shprehimisht dhe në mënyrë të pakthyeshme heq dorë, në favor të Gunvor

- (a) nga çdo e drejtë e zëvendësimit dhe çdo pretendim, veprim, mbrojtje, përjashtim ose kundërpadi që Pengdhënësi mund të ketë ndaj Shoqërisë apo ndonjë të detyruari si pasojë e ekzekutimit të Pengut të Huasë; dhe
- (b) çdo e drejtë pretendimi, veprimi, mbrojtje, përjashtimi, kundërpadie apo kompensimi që Pengdhënësi mund të ketë kundër Gunvor.

Heqja dorë është efektive në favor të Gunvor deri në lirim të Pengut të Huasë.

8.2 Pranimi nga ana e Shoqërisë dhe GUNVOR

Shoqëria dhe Gunvor njohin dhe pranojnë në mënyrë të pakthyeshme heqjen dore nga e drejta e zëvendësimit nga ana e Pengdhënësit sipas Nenit 8.1.

8.3 Nënrenditja

Pa cenuar Nenin 8.1, Pengdhënësi bie dakord se të gjitha të drejtat ose pretendimet që ai mund të ketë përkundërt Shoqërisë ose ndonjë dorëzanësi të Shoqërisë si rrjedhojë e ose në lidhje me ekzekutimin e Pengut të Huasë, do të nënrenditen pas të drejtave që Gunvor gëzon sipas Marrëveshjes së Huasë.

9. ZGJIDHJA

Përveç rastit kur Palët bien dakort me shkrim për një zgjidhje të mëparshme, ose përveç rastit kur parashikohet ndryshe në këtë Marrëveshje, të drejtat e Gunvor përfundojnë kur të gjitha Detyrimet e Siguruara të jenë shlyer plotësisht.

10. DEKLARATAT DHE GARANCITE

10.1 Deklaratat dhe Garancitë e Pengmarrësit

Pa cenuar deklaratat dhe garancitë e përcaktuara në Marrëveshjen e Huasë, Pengdhënësi i deklaron dhe garanton Gunvor-it se:

- (a) Pengdhënësi është zotëruesi i vetëm legjitim i Aksioneve dhe të Drejtave të Lidhura. Me përjashtim të Pengut të Huasë krijuar sipas ose në bazë të kësaj Marrëveshjeje, Aksionet dhe të Drejtat e Lidhura janë të lira nga çdo barrë siguruese apo peng në favor të palëve të treta;
- (b) Aksionet janë lëshuar dhe nënshkruar rregullisht dhe janë regjistruar në përputhje me dispozitat e zbatueshme të Ligjit Shqiptar si dhe janë paguar plotësisht. Pengdhënësi ka fuqi të plotë dhe të gjitha kompetencat për të krijuar një peng të vlefshëm dhe efektiv në favor të Gunvor;
- (c) Aksionet përfaqësojnë, në kohën e nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje, 100% (njëqind për qind) të kapitalit aksionar të Shoqërisë dhe, në kohën e nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje, dhe me përjashtim të aksioneve të emetuara për nënshkrim për SkySea BV, asnjë veprim nuk është ndërmarrë nga Shoqëria për të rritur kapitalin e saj;
- (d) nuk ka kërkesë padi apo pretendime në proces apo të njoftuara para asnjë gjykate apo paneli arbitrazhi, në Republikën e Shqipërisë ose jashtë saj, lidhur me Kolateralin;
- (f) dhënia, krijimi dhe kompletimi e Pengut të Huasë është brenda objektit të shoqërisë së Pengdhënësit, dhe të gjitha autorizimet e nevojshme ose të këshillueshme në lidhje me dhënien, krijimin dhe kompletimin e Pengut të Huasë janë marrë dhe janë mbajtur në fuqi të plotë dhe efektive, duke përfshirë, për shmangien e çdo dyshimi, autorizimet e përfshira nga neni 4, paragrafi (b);
- (g) Shoqëria është një shoqëri aksionare (*Shoqëri aksionare*) e themeluar rregullisht dhe në gjendje të mirë sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë, nuk është subjekt falimentimi, paaftësie paguese apo procedurave të ngjashme në Republikën e Shqipërisë ose në ndonjë juridiksion tjetër, si dhe ka dhe do të ketë në çdo kohë kompetencat e nevojshme për të marrë përsipër dhe për të përmbushur detyrimet e saj sipas kësaj Marrëveshjeje;
- (h) Pengdhënësi nuk është subjekt falimentimi, paaftësie paguese apo procedurash të ngjashme në Shqipëri, ose në ndonjë juridiksion tjetër;

(i) Pengu i Huasë:

- (i) është ofruar dhe krijuar në mënyrë të vlefshme nga Pengdhënësi dhe të gjitha detyrimet këtu përbëjnë detyrime të vlefshme, detyruese dhe të zbatueshme të Pengdhënësit dhe janë në përputhje me Ligjin Shqiptar; dhe
- (ii) ofrimi, krijimi dhe kompletimi e Pengut të Huasë si dhe dispozitat që përmbahen në këtë Marrëveshje nuk shkelin dhe nuk janë në konflikt me ndonjë marrëveshje tjetër ose angazhim ku Shoqëria dhe/ose Pengdhënësi janë palë ose me ndonjë dispozitë ligjore, vendim, dekret ose urdhër tjetër të ndonjë gjykate ose autoriteti publik, dokument të shoqërisë, ose ndonjë nga dokumentet themeluese të Shoqërisë dhe/ose Pengdhënësit; dhe
- (j) Pengdhënësi gjithashtu i deklaron dhe garanton Gunvor-it dhe merr përsipër se deklaratat dhe garancitë e mësipërme do të jënë të vërteta dhe të sakta për gjithë kohëzgjatjen e kësaj Marrëveshjeje në lidhje me faktet dhe rrethanat që lindin kohë pas kohe.

10.2 Pranime të mëtejshme dhe Përsëritja e Deklaratave dhe Garancive

Të gjitha deklaratat dhe garancitë e Pengdhënësit në këtë Nen do të konsiderohen që do të monitorohen nga Pengdhënësi çdo ditë gjatë Periudhës së Garancisë në lidhje me faktet dhe rrethanat, që ekzistojnë në atë kohë, dhe të raportojë menjëherë në rast të ndonjë ndryshimi të Deklaratave dhe Garancive të mësipërme.

11. PREMTIME TË PENGDHËNËSIT

11.1 Pa cenuar premtimet që përcaktohen në Marrëveshjen e Huasë, Pengdhënësi premtonte se përsa kohë që Detyrimeve të Siguruara nuk janë shlyer, Pengdhënësi duhet:

- (a) të mos ndërmarrë asnjë veprim i cili mund të cenojë, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, vlefshmërinë, fuqinë ose zbatueshmërinë e Marrëveshjes së Huasë (përfshirë këtë Marrëveshje) ose të drejtat dhe interesat e Gunvor sipas Marrëveshjes së Huasë.
- (b) Të ndërmarrë, me shpenzimet e tij, të gjitha veprimet që mund të jenë të nevojshme ose të këshillueshme në mënyrë të arsyeshme për të mbrojtur vlefshmërinë, efektshmërinë dhe zbatueshmërinë e kësaj Marrëveshjeje ose të drejtat e Gunvor, duke përfshirë pretendimet e ngritura nga palë të treta;
- (c) Me shpenzimet e tij, të nënshkruajë e dorezojë menjëherë të gjitha dokumentet dhe të ndërmarrë të gjitha veprimet që mund të jenë të nevojshme ose të këshillueshme për:
 - (i) regjistrimin, kompletimin dhe mbajtjen në fuqi të plotë dhe efektive Pengun e Huasë; dhe

- (ii) t'i bërë të mundur Gunvor-it që të ushtrojë të drejtat dhe mjetet ligjore për rivendosjen e tyre që gëzon në përputhje me këtë Marrëveshje, duke përfshirë, pa kufizim, të gjitha të drejtat dhe mjetet ligjore për rivendosjen e tyre të zbatueshme me ndodhjen e një Mospërmbushjeje.
- (d) të mos ndryshojë formën e shoqërisë, përveçse me miratimin me shkrim të Gunvor;
- (e) të sigurojë që çdo dhe të gjitha Aksionet e ardhshme dhe të Drejtat e Lidhura të Shoqërisë nënshkruar nga Pengdhënësi të jenë vendosur si peng dhe të jenë subjekt i Pengut të Huasë në favor të Gunvor në përputhje me Nenin 2.2.
- (f) të detyrojë Shoqërinë që të krijojë, nëse nuk ka, regjistrin e aksioneve, në të cilin Pengu i Huasë duhet të regjistrohet në përputhje me pikën 4, Nenin 547 të Kodit Civil dhe nenit 119 i ligjit shqiptar për shoqëritë tregtare;
- (g) të detyrojë Shoqërinë për të mbajtur librat e duhur dhe të mundësojë që Gunvor të ketë akses të arsyeshëm si dhe të bëjë kopje ose të marrë ekstrakte nga këto libra nëse kërkohet;
- (h) të mos krijojë ose të lejojë krijimin, mbi të gjithë ose mbi ndonjë pjesë të Kolateralit, të çdo barre, interesi të siguruar, barre sigurorese, peng, garanci, ose ekzistencën e ndonjë të drejte të ndonjë palë të tretë, qoftë si të radhës së parë, pari passu ose të nënrenditura ndaj Pengut të Huasë, të përfshirë në këtë Marrëveshje, përveç pengjeve dhe barrëve të tjera të krijuara ose shprehimisht të lejuara që të krijohen sipas kësaj Marrëveshjeje ose Marrëveshjes së Huasë ose me pëlqimin me shkrim nga Gunvor.
- (i) të mos transferojë ose të disponojë në ndonjë mënyrë tjetër të drejtat e tij, dhe interesat në Kolateralin;
- (j) me përjashtim të zmadhimit së kapitalit me anë të nënshkrimit në favor të Gunvor, të mos emetojë Aksione të reja të Shoqërisë në favor të palëve të treta, përveç nëse Gunvor shprehimisht jep pëlqimin me shkrim se një palë e tretë mund të nënshkruajë ndonjë zmadhim të tillë ose një pjesë të tij, rast në të cilin Pengdhënësi do të sigurojë që kjo palë e tretë do të lidhë një kontratë pengu thelbësisht në formën e kësaj Marrëveshjeje të gjitha aksionet e nënshkruara për prej ta;
- (k) të zbatojë dhe të respektojë, ose të shkakttojë që të zbatohen dhe të respektohen, të gjithë afatet, premtimet dhe kushtet që duhet të zbatohen dhe respektohen prej tij sipas Marrëveshjes së Huasë, si dhe të njoftojë menjëherë Gunvor me shkrim për çdo njoftim që këta marrin ku pretendohet Mospërmbushja e Shoqërisë sipas kësaj Marrëveshjeje të Huasë;
- (l) të dëmshpërblejë Gunvor dhe ta ruajë atë të paprekur nga çdo dhe të gjitha pretendimet, akuzat apo paditë e ngritura dhe/ose të paraqitura nga palë të treta, të cilat lidhen me Kolateralin dhe/ose Pengun e Huasë;

- (m) dorëzojë menjëherë Gunvor-it të gjitha njoftimet në lidhje me Kolateralin si dhe të kryejë, dhe të bëjë Shoqërinë të kryejë, të gjitha veprimet (duke përfshirë, pa kufizim, në ushtrimin e së drejtës së votës të lidhur me Aksionet) të cilat mund të jenë të nevojshme ose të këshillueshme për të mbrojtur vlefshmërinë, efektivitetin dhe zbatueshmërinë e kësaj Marrëveshjeje ose të të drejtave të Gunvor, edhe kundër pretendimeve të bëra nga palët e treta;
- (n) të nënshkruajë, të njohë dhe të dorëzojë të gjitha ato kalime, transferime dhe dokumente që mund të kërkojnë në mënyrë të arsyeshme nga Gunvor për t'i dhënë fuqi kësaj Marrëveshjeje dhe të paguajë të gjitha shpenzimet për kërkime, regjistrime dhe depozitime; dhe
- (o) të njoftojë Gunvor për çdo ndryshim të emrit të Pengdhënesit dhe/ose Shoqërisë brenda 5 (pesë) Ditëve Punë, që nga data kur një ndryshim i tillë ka ndodhur.

11.2 Njohja nga ana e Shoqërisë

Shoqëria njeh angazhimet e Pengdhënesit sipas kësaj Marrëveshjeje dhe bie dakord se nuk do të ndërmarrë asnjë veprim i cili mund të cenojë ose pengojë zbatimin e tyre.

12. DËMSPËRBLIMI, TAKSAT, KOSTOT DHE SHPENZIMET

12.1 Përgjegjësia e Pengdhënesit

Përveç dëmeve për shkak të neglizhencës së rëndë ose sjelljes keqdashëse, Gunvor nuk do të jetë përgjegjës për dëmet që i shkaktohen Shoqërisë gjatë ushtimit ose mos ushtrimit të të drejtave, veprimeve ose mjeteve ligjore për rivendosjen e të drejtave që i njihen sipas kësaj Marrëveshjeje.

12.2 Dëmshpërblimi

Me paraqitjen e një kërkesë, Pengdhënesi do të rimbursojë Gunvor për të gjitha taksat dhe tatimet, kostot, shpenzimet dhe tarifat (duke përfshirë tarifat ligjore dhe noteriale) të përballuara nga Gunvor në lidhje me:

- (i) krijimin, ruajtjen, ose zbatimin e Pengut të Huasë; dhe
- (ii) çdo mospërbushje nga Pengdhënesi dhe/ose Shoqëria për të respektuar detyrimet që lindin ose që lidhen me këtë Marrëveshje.

13 NJOFTIMET

13.1 Një njoftim ose komunikim tjetër për ose në lidhje me këtë Marrëveshje ("Njoftimi") duhet të jetë:

13.1.1 me shkrim;

13.1.2 në gjuhën angleze; dhe

13.1.3 dorëzohen personalisht ose të dërgohet me postë të regjistruar dhe të parapaguar, faks ose korrier duke përdorur një kompani të njohur ndërkombëtarisht të njohur nga pala tjetër

në mënyrë për të marrë njoftimin në adresën e përcaktuar në nenin 13.3, me një kopje të këtij njoftimi ose komunikimi të dërguar njëkohësisht nga email.

13.2 Pala mund të ndryshojë të dhënat e saj të njoftimit, duke i dhënë njoftim me shkrim për ndryshimin palëve të tjera i marrë jo më pak se pesë ditë pune përpara se Njoftimi të jetë dërguar.

13.2 Dërgesa e konsideruar e dorëzuar

Nëse nuk ka prova se dërgesa ishte marrë më parë, një Njoftim konsiderohet i dhënë:

13.2.1 nëse dorëzohet personalisht ose dërgohet me postë, kur lihet në adresën e përmendur në pikën 13.3;

13.2.2 nëse dërgohen me postë të regjistruar dhe para-paguar, në 9.30 paradite të ditës së pestë të punës pas postimit apo, në qoftë se më parë, në kohën e regjistruar nga ofruesi i shërbimeve; dhe

13.2.3 nëse dërgohen me faks, kur konfirmimi i transmetimit të tij është regjistruar nga faksi i dërguesit.

Çdo lajmërim i dhënë sipas kësaj Marrëveshjeje jashtë orarit të punës në vendin të cilit i drejtohet, do të konsiderohet se nuk është dhënë deri në fillimin e periudhës së ardhshme të orarit të punës në vend të tillë.

13.3 Adresat për njoftimet

Adresat referuar në Nenin 13.1.3 dhe 13.2.1 janë:

13.3.1 Në rastin e Pengmarrësit:

Adresa:

c/o Gunvor SA, 80-84 Rue du
Rhône, 1204 Geneva,
Switzerland

Fax:

+41 22 718 79 29

Në vëmendje të:

Mr. Gia Mai

me një kopje (e cila nuk perben njoftim)

me e-mail tek:

gia.mai@gunvorgroup.com

13.3.2 Në rastin e Pengdhënësit:

Adresa:

Passage des Lions 6
1204 Geneva, Switzerland

Në vëmendje të:

Mr. Christophe Darbord

me një kopje (e cila nuk perben njoftim)

me e-mail tek:

chrisfbdarbord@yahoo.com

13.3.3 Në rastin e Shoqërisë

Adresa:

Rr. Ibrahim Rugova, Nr.5, Sky
Tower, 13/4, Tirana, Albania

Në vëmendje të:
me nje kopje (e cila nuk perben njoftim)
me e-mail tek:

The Chief Executive Officer

Joel.chevallaz@mangeat.ch

14. DISPOZITA TE NDRYSHME

14.1 Ndryshimet dhe heqja dorë

Asnjë ndryshim ose heqja dorë nga kushtet e kësaj Marrëveshje dhe asnjë pëlqim apo miratim nga ana e Gunvor nuk do të ketë efekt përveç rasteve kur bëhet me pëlqimin me shkrim të Palëve. Gunvor mund të lejojë zgjatjen e afatit dhe lëshime të tjera, të bëjë kompromise, të bjerë dakord, të çlirojë dhe shkarkojë nga detyrimet e Shoqërisë dhe Kolateralit, sic Gunvor mund të gjykojë të arsyeshme, pa cenuar përgjegjësinë e Shoqërisë dhe Pengdhënësit dhe të drejtat e Gunvor sipas kësaj Marrëveshjeje ose Ligjit Shqiptar.

14.2 Ndryshimi, kalimi, përtëritja

Kjo Marrëveshje do të jetë e detyrueshme për Pengdhënësin dhe Shoqërinë si dhe trashëgimtarët e saj dhe për të tretët të cilëve mund t'u transferohen të drejtat dhe detyrimet përsa lidhet me ndryshimin, transferimin apo ripërtëritjen e Marrëveshjes së Huasë ose kësaj Marrëveshjeje dhe Pengdhënësi dhe Shoqëria shprehimisht bien dakord për vazhdimësinë e kësaj Marrëveshjeje në rast ripërtëritje të plotë ose të pjesshme të Detyrimeve të Siguruara, dhe Pengdhënësi dhe Shoqëria marrin përsipër të konfirmojnë me shkrim, nëse kjo kërkohet nga Pengmarrësi ose Huadhënësi në të njëjtin moment ose para ndonjë modifikimi, kalimi ose ripërtëritje e Marrëveshjes së Huasë dhe/ose kësaj Marrëveshjeje, ose transferimin ose cedimin e Detyrimeve të Siguruara, lidhur me vullnetin e tyre për vazhdimësinë e kësaj Marrëveshjeje.

14.3 Kalimi

Pengdhënësi nuk do të transferojë apo cedojë, plotësisht apo pjesërisht asnjë nga të drejtat e tij sipas kësaj Marrëveshjeje pa pëlqimin paraprak të Gunvor. Gunvor mund të transferojnë të drejtat e tij sipas kësaj Marrëveshjeje, tek çdo palë tjetër pa pëlqimin paraprak të Pengdhënësit dhe/ose Shoqërisë.

14.4 Rivendosja tërësore e të drejtave

- (i) Të drejtat, kompetencat dhe mjetet ligjore për rivendosjen e tyre të Gunvor sipas kësaj Marrëveshjeje i shtohen njëra tjetrës dhe nuk përjashtojnë dhe as nuk interpretohen se do të përjashtojnë të drejtat, kompetencat dhe apo mjetet ligjore për rivendosjen e tyre që

parashikohen nga ligji apo ndryshe dhe që mund të ushtrohen herë pas herë që Gunvor do ta quajë të përshtatshme.

- (ii) Asnjë vonesë ose mos ushtrim nga ana e Gunvor i të drejtave dhe mjeteve ligjore për rivendosjen e tyre nuk do të cenojë këto të drejta apo mjete ligjore apo do të shërbejë apo do të quhet si heqje dorë nga këto dhe ushtrimi i pjesshëm apo jo i plotë i vetëm prej këtyre të drejtave dhe mjeteve ligjore nuk do të përjashtojë ushtrimin e të drejtave dhe mjeteve ligjore të tjera dhe të mëtejshëm sipas kësaj Marrëveshje.

14.5 Taksat dhe Shpenzimet

Të gjitha detyrimet, taksat apo tarifat e tjera publike përfshirë por pa u kufizuar në taksat, tarifat e regjistrimit në gjykatë dhe tarifat e noterit, shpenzimet, pagesat dhe tarifat që duhet të paguhen e janë të pagueshme në lidhje me përgatitjen, negocimin, kompletimin, dorëzimin, regjistrimin, depozitimin, kompletimin, ekzekutimin, perfeksionimin, ndryshimin, heqjen dorë, pëlqimin, shkarkimin nga detyrimi, clirimin, ruajtjen dhe zbatimin e kësaj Marrëveshje dhe Pengun e Huasë do të mbahen përsipër nga Pengdhënësi. Në rast se një nga këto detyrime paguhet nga Gunvor, Pengdhënësi do të rimbursojë Gunvor për të gjitha këto detyrime, menjëherë pasi të ketë marrë nga Gunvor kërkesën përkatëse të shoqëruar me një faturë apo dokument tjetër që vërteton në mënyrë të arsyeshme pagesat e kryera nga Gunvor.

14.6 Marrëveshja e Pengut


Çdo deklaratë, certifikatë apo përcaktim i Gunvor në lidhje me Detyrimet e Siguruara ose (pa u kufizuar) çdo çështje tjetër që parashikohet në këtë Marrëveshje, në rast se nuk ka gabime, do të jetë përfundimtare dhe e detyrueshme për Pengdhënësin.

14.7 Garanci e veçantë

Palët këtu pranojnë dhe konfirmojnë shprehimisht se Pengu i Huasë përbën një garanci për Gunvor dhe të ndarë, dhe pa lidhje me, çfarëdolloj garancie tjetër që i është dhënë apo do ti jepet nga Shoqëria ose nga ndonjë prej ortakëve të shoqërisë Gunvorit, për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të Pengdhënësve dhe Shoqërisë sipas Marrëdhënies së Huasë. Palët këtu bien dakord se Gunvor ka të drejtë të ushtrojë të drejtat e tij që rrjedhin nga kjo Marrëveshje pavarësisht nga të drejtat e saj/tyre që rrjedhin nga ndonjë garanci tjetër për shlyerjen e detyrimeve të Pengdhënësve dhe Shoqërisë sipas Marrëveshjes së Huasë.

14.8 Ruajtja e vlefshmërisë së Marrëveshjes

Në rast se në çdo kohë një ose me shumë dispozita të kësaj Marrëveshje është apo do të bëhet e paligjshme, e pavlefshme apo e pazbatueshme sipas ligjit të çdo juridiksioni, atëherë as ligjshmëria, vlefshmëria apo zbatueshmëria e dispozitave të tjera të kësaj Marrëveshjeje dhe as ligjshmëria, vlefshmëria dhe zbatueshmëria e asaj dispozite sipas ligjit të një juridiksioni tjetër nuk do të cenohet apo dëmtohet si rrjedhojë e kësaj. Nëse ndonjë prej dispozitave është e pavlefshme por do të bëhet e vlefshme në rast se disa pjesë të saj do të anuloheshin, dispozita në fjalë do ti nënshtrohet atyre ndryshimeve të cilat do ta kthenin atë në një dispozitë të vlefshme.



15 LIGJI I ZBATUESHËM DHE JURIDIKSIONI

15.1 Ligji i zbatueshëm

Kjo Marrëveshje rregullohet dhe interpretohet në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë.

15.2 Organi i Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve

- (a) Çdo Marrëveshje, kundërshtim apo pretendim që lind apo lidhet (1) me këtë Marrëveshje, (2) shkelje, zgjidhje apo pavlefshmëri e saj, ose (3) të gjitha detyrimet jo-kontraktuale që dalin nga ose në lidhje me këtë Marrëveshje, duke përfshirë çdo mosmarrëveshje në lidhje me ekzistencën, vlefshmërinë, interpretimin, performancën, shkelje ose zgjidhjen apo pasojat e pavlefshmërisë dhe çdo marrëveshje në lidhje me ndonjë detyrim jo-kontraktual që dalin nga ose në lidhje me të (për qëllime të këtij neni 15.2, një Mosmarrëveshje) do të referohet dhe më në fund të zgjidhet nga gjykatat kompetente shqiptare sipas ligjit shqiptar.
- (b) Selia, ose vendi i procedurave ligjore do të jetë sipas përcaktimeve të Ligjit Shqiptar.
- (c) Gjuha e përdorur në procedurat gjyqësore dhe të gjitha dokumentet e dorëzuara në lidhje me procedurat duhet të jetë në gjuhën dhe përgatitur siç parashikohet në ligjin shqiptar.
- (d) Për qëllimet e kësaj marrëveshje Pengdhënësi në mënyrë të parevokueshme përcakton, emëron dhe fuqizon agentin e tij të autorizuar siç specifikohet në Marrëveshjen e Huasë për të marrë njoftim gjyqësor dhe çdo thirrje ligjore tjetër në Angli në lidhje me ndonjë veprim apo proces të ngritur nga Pengmarrësi ose ndonjë Huadhënës në Angli (nëse ka) në lidhje me këtë Marrëveshje për shkak të Marrëveshjes së Huasë.

15.3 Heqja dorë dhe Imuniteti

Pengdhënësi dhe Shoqëria deklarojnë dhe garantojnë se kjo Marrëveshje si dhe detyrimet e shkaktuara nga Pengdhënësi dhe/ose Shoqëria në lidhje me huanë janë komerciale në vend të akteve publike apo qeveritare dhe se Pengdhënësi dhe Shoqëria nuk kanë të drejtë të kërkojnë imunitet nga procedurat ligjore në lidhje me veten e tyre ose ndonjë nga aktivet e tyre në lidhje me sovranitetin ose ndryshe sipas ndonjë ligji ose në ndonjë juridiksion ku një veprim mund të silltet për zbatimin e ndonjë prej detyrimeve që dalin nga ose në lidhje me këtë Marrëveshje. Në kufijtë që Pengdhënësi dhe Shoqëria apo asetet e tyre kanë apo në të ardhmen mund të fitojnë të drejta imuniteti nga likuidimi, proceset gjyqësore, urdhër gjykate për konfiskim para vendimit apo urdhër tjetër apo ekzekutim vendimi në bazë të së drejtës sovrane apo ndryshe Pengdhënësi dhe Shoqëria heqin dorë përfundimisht nga këto të drejta imuniteti në lidhje me detyrimet që lindin nga apo lidhen me këtë Marrëveshje.

16. KOPJET

Kjo Marrëveshje do të nënshkruhet në 10 (dhjetë) kopje, 5 (pesë) prej të cilave janë në Anglisht dhe 5 (pesë) në Shqip. Në rast se ka një konflikt midis versionit Anglisht dhe Shqip, versioni Anglisht do të mbizotërojë.

Pengmarrësi:

SkySea B.V.

Nga:

Emri:

Titulli:

ADI BREVINA
JURIST



Pengdhënësi:

CFD CONSEILS SARL

Nga:

Emri:

Titulli:

Blevis Hoxha

Shoqëria:

TOSK ENERGY SHA

Nga:

Emri:

Titulli:

Blevis Hoxha



SHTOJCA 1

Forma e shënimit në regjistrin e aksioneve të Shoqërisë

Është pranuar se nëpërmjet një marrëveshje së pengut mbi Aksionet datë 30.9.2016 ("Marrëveshja"), CFD Conseils SARL (CFD) një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e regjistruar sipas ligjeve të Zvicrës, me seli ligjore në adresën Passage des Lions 6, 1204 Gjeneve, Zvicër ("Pengdhënësi") është zotërues i 100 (njëqind) të Aksioneve të Tosk Energji SHA ("Shoqëria") me vlerë nominale secila 35,000,00 ALL (tridhjetë e pesë mijë Lekë), të cilat përfaqësojnë 100% të kapitalit të Shoqërisë, dhe kanë vendosur një peng mbi këto aksione në favor të SkySea B.V, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e regjistruar sipas ligjeve të Holandës dhe seli kryesore të biznesit në Barbara Strozilaan 201, 1083HN Amsterdam, Holandë ("Pengu i Huasë")


Këto Aksione janë subjekt pengu për detyrimet e marra përsipër nga ana e Shoqërisë, siç përcaktohen në Marrëveshje. Të drejtat e votës dhe e drejta e dividendit rregullohen nga Neni 6 i Marrëveshjes, një kopje e së cilës duhet të depozitohet dhe të mbahet nga Shoqëria.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

DHOMA E NOTERËVE TIRANE

Nr._1510_rep.



VËRTETIM

NËNSHKRIMI

Sot, në datë 30 Shtator 2016 (dy mijë e gjashtëmbëdhjetë), ditën e Premte, u paraqitën përpara meje noterit Donika A.Gjini, anëtar i Dhomës së Noterisë Tiranë, me adresë Blv.B.Curri, Tiranë:

1. – **Blerim Hoxha**, shtetas kosovar, lindur me 12.04.1983 në Suharekë, Kosovë, mbajtes i pasaportës nr.P0023119, madhor dhe me zotësi juridike të plote për të vepruar, në cilësinë e Administratorit të Shoqërisë "Tosk Energji" shad he në cilësinë e Perfaqësuesit me Prokurë të Shoqërisë CFD Conseils SARL;

2. - **Adi Brovina**, shtetas shqiptar, lindur e banues në Tiranë, dtl.01.05.1984 me letërnjoftim nr.027201682/I40501090D, madhor dhe me zotësi juridike të plote për të vepruar, në cilësinë e Perfaqësuesit me Prokurë të Shoqërisë SkySea B.V.

të cilët më deklaruan se kanë përpiluar dhe nënshkruar "Pledge Agreement over Shares/Marreveshje Pengu mbi Aksionet e Shoqërisë Tosk Energji sh.a date 30 September/Shtator 2016" me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë dhe unë noteri vërtetoj nënshkrimin e tyre sipas ligjit.



NOTERE

DONIKA GJINI

